



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 22.08.2025
Numër Protokolli: 5761/2025

A.nr.1207/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1207/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesi A.Ç, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.1207/2025 e datës 24.06.2025, e parashtruar nga ankuesi A.Ç.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.Ç (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 24.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4304/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1207/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me pretendimin ankimor për uljen e pagës së tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit, më datë 14.07.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 24.06.2025, **është e palejuar, sepse:**

Nga provat e lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, rrjedhimisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, në kuptim të Nenit 102, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ka lëshuar ankuesit Akt emërimit me numër protokolli 5541 të datës 22.10.2024, për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Emergjencë”, pranë Departamentit të Qendrës për Menaxhimin e Emergjencave.

Ndërsa, i njëjti sipas Vendimit me Nr.Ref.675/2018 të datës 24.07.2018, të Zëvendëskryeministrit të Parë dhe njëkohësisht Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të atëhershëm, i është dhënë grada diplomatike *Sekretar i Dytë*, kurse sipas Vendimit me Nr.Ref.53/2025 të datës 25.02.2025, të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Ministrisë Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i njëjti është caktuar të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb, Republika e Kroacisë, me mandat katër (4) vjeçar, dhe atë duke filluar nga data 01.04.2025.

Ankuesi, me datë 24.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për uljen e pagës, ku sipas tij në fund të shërbimit të kaluar në Zagreb paga ka qenë 2022.57 Euro, ndërsa që prej disa muajsh në mision paga i është ulur në shumën 1958.61 Euro, andaj kërkon nga Këshilli, aprovimin e ankesës dhe kthimin e të drejtës në pagë siç ka qenë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore konstatoi se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, mirëpo kur kemi të bëjmë me realizimin e të drejtave sikurse në rrethanat e rastit konkret për kompensimin material lidhur me uljen e pagës siç pretendon ankuesi, nëpunësi civil fillimisht duhet t’i drejtohet organit të punësimit me kërkesë për realizimin e të drejtës së pretenduar, dhe vetëm kundër aktit për refuzimin e kërkesës apo heshtjes së organit publik në raport me kërkesën e parashtruar, mund të parashtoj ankesë, sipas afateve të përcaktuara me dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kolegji i Këshillit, bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht përgjigjes në ankesë të organit të punësimit, ka konstatuar se ankuesi për kompensimin material lidhur me uljen e pagës, për çka edhe ka parashtruar ankesë, nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë organit të punësimit, gjegjësisht Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, veprim ky i domosdoshëm për iniciimin e procedurës administrative sipas dispozitave të ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Si rrjedhojë, në mungesë të kërkesës së parashtruar të organi i punësimit për realizimin e të drejtës së pretenduar, nga ankuesi, në rastin konkret nuk kemi objekt trajtimi ngase mungon veprimi apo mosveprim nga organi i punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesi mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi nuk ka parashtruar kërkesë të organi përkatës i punësimit për realizimin e kompensimit material lidhur me uljen e pagës, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1207/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.Ç;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.